



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 294, Datë 26.12.2024

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 262, DATË 02.12.2024  
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SLR ALBANIA” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2622 prot., datë 26.12.2024, të Drejtorisë së Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 262, datë 02.12.2024 “Mbi licencimin e shoqërisë “SLR ALBANIA” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 262, datë 02.12.2024, ka vendosur të licencojë shoqërinë “SLR ALBANIA” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Në pikën 2 të këtij vendimi është përcaktuar si kusht se: “Përpara fillimit të operimit, shoqëria “SLR ALBANIA” sh.p.k. të depozitojë në ERE, VNM-në Paraprake të re” dhe në pikën 3 përcaktohet se “Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, brenda afateve të përcaktuara në kontratën me MIE-n”.
- Shoqëria “SLR ALBANIA” sh.p.k. ka dorëzuar më datë 03.12.2024, në adresën zyrtare elektronike të ERE-s, një kopje të Vendimit për VNM paraprake, të miratuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Ky vendim mban datën 02.12.2024, me nr. serial AN011020240006 dhe nr. Komisioni 158.
- Afati i vlefshmërisë së kësaj VNM-je paraprake përcaktohet si më poshtë vijon:
  - Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.

- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.
- Në këto rrethana, shoqëria “SLR ALBANIA” sh.p.k. ka përmbushur kushtin e përcaktuar në pikën 2 të vendimit nr. 262, datë 02.12.2024, të bordit të ERE-s, duke dorëzuar një vendim të ri për VNM paraprake.
- Bazuar në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili përcakton se: *një akt administrativ mund të anulohet ose shfuqizohet kryesisht nga organi publik që ka kompetencën për ta nxjerrë, nga organi i tij epror ose nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj*, vlerësojmë se pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 262, datë 02.12.2024, duhet të shfuqizohet, pasi shoqëria “SLR ALBANIA” sh.p.k. ka përmbushur kushtin e vendosur nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s, nr. 262, datë 02.12.2024, shfuqizohet.
2. Drejtoria e Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë shoqërinë “SLR ALBANIA” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**